



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KUKES**



VENDIM

Nr. 7 Date 06.02.2014

**PER PAGESEN E KUOTES SE ANTARSIMIT NE ASAMBLENE EUROPIANE TE
RAJONEVE (AER)**

Këshilli i Qarkut Kukës në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pas shqyrtimit të Relacionit dhe P/Vendimit të paraqitur nga Keshilltari i M. me Jashtë, bazuar në nenin 109/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin Nr.8652 datë 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore,, nenet 7/2, 8/V/b, 19 dhe 54, ligjit Nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjin Nr.8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore” neni 10, VKM Nr.228 datë 23.04.2004 “Per rregullimin e marrëdhënieve me jashtë të administratës shtetërore”, ligjin Nr. 185/2013 miratuar me datë 28.12.2013 “Per buxhetin e vitit 2014”, ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, kërkesës së bere nga AER datë 04.11.2013, si dhe vendimin e Kryesise së Keshillit të Qarkut Kukës Nr.1, datë 06.02.2014 “Per miratimin e P/Akteve për mbledhjen e Keshillit të Qarkut Kukës”,

VENDOSI:

1. Të miratojë shumën prej 3180,00 € (Euro) si pagesë e kuotës së antarësimit në Asambleenë Rajonale të Europës (AER) për vitin 2014.
2. Të autorizojë Zyrën e Financës pranë Këshillit të Qarkut Kukës që të bëjë pagesën e kuotës vjetore të antarësimit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit të Qarkut Kukës, Zyra e Financës, si dhe Keshilltari për Marrëdhëniet me Jashtë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konc: E.Shaqiri
Ligjshmeria: G.Çejku
Sekretari: B.Ngjeci

U hartua në 4 (katër) kopje origjinale:
1. Zyres së Protokoll Arkivit
2. Institucionit të Prefektit të Qarkut Kukës
3. Zyres së Financës

KRYETARI

Ibsen ELEZI

